

SHTOJCA NR 2

Per disa ndryshime ne Kriteret per Kualifikim të Tenderit: "**Rehabilitim i Lumit Gjanica dhe Rikonceptim i Qendres se qytetit te Fierit**".



Qendres se qytetit te Fierit" ndryshojne dhe behen si me poshte :

Shtojca 12

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- b) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- c) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, (nëse është e zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- b. *Deklaratë mbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- c. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- ç. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- d. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- dh. *Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10*
- e. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Objekti i “Ndertim” duhet të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së operatorit ekonomik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Xhiro mesatare e realizuar nga Operatori Ekonomik gjate tre viteve te fundit (2015, 2016 dhe 2017) duhet te mos jete me e vogel se 40% e vleres se fondit limit pa tvsh. Per te vertetuar plotesimin e ketij kusht

Operatori Ekonomik duhet te paraqese nje vërtetim nga Dega e Tatim Taksave për xhiron vjetore të realizuar në 3 (tre) vitet e fundit.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet te kete nje aktivitet pozitiv te qendrueshem gjate tre viteve 2015, 2016 dhe 2017. Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese kopje të bilanceve të ketyre tre viteve, të paraqitur pranë autoritetit përkatëse, të konfirmuara me shkrese te vecante nga ky autoritet si dhe te shoqeruara nga akt ekspertiza e kryer nga Eksperti kontabel i autorizuar.

2.2.3 Operatori Ekonomik duhet te paraqese një deklaratë me shkrim nga administratori se subjekti ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per periudhen nga 1 janari 2017 deri ne daten 30 qershor 2018. Kesaj deklarate duhet ti bashkengjiten te gjithë vertetimet qe deshmojne se operatori ekonomik **ka paguar detyrimet perkatese**, ne vendet ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet per kete periudhe, shoqeruar me mandatet perkates te pagesave. **Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".**

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet te kete realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 50% e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, ose

punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 200% e vleres se fondit limit.

Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshtruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore perkatese.

2.3.2 Të ketë të punësuar minimalisht 170 persona për periudhën Janar 2018 – Maj 2018, të vërtetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për kete periudhë, shoqeruar me formularët e listepagesave E-SIG.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet te deklaroje me shkrim se punonjesit e kerkuar ne piken 2.3.2 per kualifikim nuk jane te deklaruar ne procedurat e prokurimit qe operatori ekonomik ka aktualisht ne proces zbatimi punimesh.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet te vertetoje se disponon kualifikimet e duhura te stafit drejtues perkates per kryerjen e te gjitha punimeve ne kete objekt. Per kete operatori ekonomik duhet te paraqese propozimin e tij (sipas tabelës se meposhtme) me emrin e inxhinierit per secilin post, shoqeruar me diplomë, kontratë pune te vlefshme dhe CV per secilin inxhinier, per:

- 1 (nje) urbanist
- 1 (nje) arkitekt
- 2 (dy) inxhinier ndërtimi
- 1 (një) inxhinier ndërtimi me profilin struktura
- 2 (një) inxhinier hidroteknike
- 2 (dy) inxhinier gjeodete/markshajder
- 1 (një) inxhinier elektrik
- 1 (një) inxhinier mekanik
- 1 (një) inxhinier gjeolog
- 1 (një) inxhinier mjedisi

NR	INXHINIERI	EMRI MBIEMRI	SHOQERIA KU PUNON
----	------------	--------------	-------------------

			AKTUALISHT
1	Urbanist		
2	Arkitekt		
3	Inxhinjer ndërtimi		
4	Inxhinjer ndërtimi		
5	Inxhinier ndërtimi me profilin struktura		
6	Inxhinjer hidroteknik		
7	Inxhinjer hidroteknik		
8	Inxhinjer gjeodet		
9	Inxhinjer gjeodet		
10	Inxhinjer elektrik		
11	Inxhinjer mekanik		
12	Inxhinjer gjeolog		
13	Inxhinjer mjedisi		

Ne rastet e bashkimit të Operatoreve Ekonomike propozimi duhet të firmoset nga të gjitha shoqëritë e bashkimit.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të deklarojë me shkrim se inxhinieret e kërkuar në pikën 2.3.4 për kualifikim janë të pa angazhuar në kontrata të tjera dhe, në rast se shpallen fitues për këtë procedurë, do të qëndrojnë në objekt gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve.

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vertetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të vepohet në përputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Për Prokurimin Publik".

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e tij mjekun e shoqërisë, në zbatim të VKM nr. 742, datë 06.11.2003. Për këtë duhet të paraqesë kontratën e punës, diplomën, licencën perkatese dhe një deklaratë se mjeku është i regjistruar dhe për të paguhen rregullisht sigurimet shoqërore.

2.3.7 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën perkatese të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008, "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi". Shqyrtimi i licensave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara në sa më sipër.

Licensa profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

- Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë licencat e mëposhtme:

- N.P – 1. A Punime gjurmimi në tokë.
- N.P – 2. C Ndërtime civile dhe industriale
- N.P – 3. C Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile dhe industriale , veshje fasade.
- N.P – 4. C Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- N.P – 5. C Punime nëntokesore, ura dhe vepra arti.
- N.P – 7. B Ujesjellesa, gazsjellesa. vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje
- N.P – 8. A Ndërtime detare dhe punime thellimi në ujë
- N.P – 9. D Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime
- N.P – 11. A Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.P – 12. A Punime të inxhinierisë së mjedisit.

- Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:

N S – 1.	B	Punime për prishjen e ndertimeve
N S – 4.	C	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
N.S – 5	A	Impiante të sinjalistikës ndriçuese të trafikut
N.S – 6.	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese.
N.S– 8.	C	Ndertime Parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druri
N.S – 13.	A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni
N.S - 15	D	Pastrimi i ujerave detare, liqenore dhe lumore
N.S - 18	B	Punime topogjeodezike
N.S - 20	A	Shpime gjeologo-Inxhinierike, puse e shpime për ujë

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik.

Kerkohen të jenë në dispozicion këto mjete pune:

1. Eskavator me zinxhire – 4 copë
2. Eskavator me goma – 3 cope
3. Eskavator me krah të gjatë, mbi 18m - 1 cope
4. Grejder – 1 copë
5. Fabrikë asfalti – 1 copë
6. Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës jo më pak se 20 ton – 8 copë
7. Kamionçinë (deri në 6 ton) – 5 copë
8. Gurëthyes, frontoje – 1 copë
9. Impiant automatik betoni – 1 copë
10. Vibrator – 6 copë
11. Rrul hekur – hekur (kapaciteti jo më pak se 8 ton) – 2 copë
12. Asfalto-shtruese – 1 copë
13. Rrul gome – hekur (kapaciteti jo më pak se 18 ton) – 2 copë
14. Rrul asfalti me gome - gome (Kapaciteti jo më pak se 18 ton) – 1 copë
15. Furçe mekanike për pastrim(fshese) – 1 copë
16. Kompresor – 2 copë
17. Matrapik - 4 copë
18. Autobot uji – 2 copë
19. Freze asfalti – 2 copë
20. Autobetoniere – 4copë
21. Mjet autovinç – 2 copë
22. Buldozer – 1 copë
23. Skeleri fasade 10,000 m2
24. Makineri për punime në lartësi(makine kulle) - 1 cope

- Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të subjektit, duhet të paraqiten kontratat e shitblerjes dhe faturat tatimore të shitjes, ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqiten kontratat e qerave, faturat tatimore të shitjes dhe kontratat e shitblerjes. Faturat që nuk janë sipas formatit të miratuar

me tvsh (faturat e biznesit te vogel) duhet te shoqerohen me kuponin tatimor.

- Për mjetet vetelevizes që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; - certifikaten e kontrollit teknik; vertetimin e pageses per taksat vjetore; siguracionin dhe fotot perkatese; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase.
- Për mjetet vetelevizes që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase.
- Për fabriken e asfaltit dhe impiantin e betonit, nese jane ne pronesi, duhet të paraqitet vendndodhja (ne distance teknikisht te pranueshme nga objekti, per te garantuar hedhjen e betonit dhe asfaltit brenda kushteve teknike), kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese. Nese jane te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase. Operatori ekonomik per fabriken e asfaltit dhe impiantin e betonit mund te paraqese edhe kontrata te vlefshme furnizimi me operatore ekonomike te zones (ne distance teknikisht te pranueshme nga objekti, per te garantuar hedhjen e betonit dhe asfaltit brenda kushteve teknike). Ne kete rast duhet te paraqese kontraten e furnizimit dhe dokumentacionin qe verteton ekzistencen dhe pronesine e impiantit.

2.3.9 Makinerite e mesiperme nuk duhet te jene te angazhuara ne kontrata te tjera. Per kete te paraqitet nje deklarate nga administratori i shoqerise ofertuese se makinerite e mesiperme nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera.

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" të Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

2.3.10 Operatori Ekonomik duhet te plotesoje kerkesat e Vendimit te Keshillit te Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi IIb. Per te provuar plotesimin e kesaj kerkese duhet te deklaroje te gjitha punet ne proces per te cilat ka lidhur kontrate apo eshte ne proces te lidhjes se saj, si kontraktor apo nenkontraktor, sipas tabelës se meposhtme:

NR	OBJEKTI I KONTRATES	AUTORITETI KONTRAKTOR	VLERA E KONTRATES PA TVSH	DATA E FILLIMIT TE PUNIMEVE OSE DATA E PARASHIKUAR PER LIDHJEN E KONTRATES	DATA E PUNIMEVE OSE DATA E PARASHIKUAR PER PUNIMEVE
1					
2					
3					
4					
5					

Gjithashtu operatori ekonomike duhet te paraqese nje vetëdeklarim që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nëkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent. Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

2.3.11 Operatori Ekonomik duhet te disponoje çertifikatat:

ISO 9001:2008

ISO 14001:2004

OHSAS 18001:2007

Çertifikatat kerkohet te jene te vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit, dhe te jene ne perputhje me nenin 30 te Vendimit te Keshillit te Ministrave nr. 914, date 29.12.2014, i ndryshuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Preventivi i punimeve ndryshon dhe behet sipas preventivit te ngarkuar ne sistem me emertim “Preventivi i ndryshuar”.

Afati per dorezimin dhe hapjen e ofertave ndryshon si me poshte:

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje ishte: Data: 22.07.2018 Ora: 10.00.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje behet: Data: 30.07.2018 Ora: 10.00.

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje ishte: Data: 22.07.2018 Ora: 10.00.

Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje behet: Data: 30.07.2018 Ora: 10.00.

Njesia e Prokurimit

